



## MINISTRI HASANI TAKON PAPA FRANÇESKUN: TË PALËKUNDUR NË ANGAZHIMIN TONË NË PROMOVIMIN E HARMONISË DHE TOLERANCËS FETARE

Gjatë vizitës së tij zyrtare në Vatikan, MEPJ Iglj Hasani u prit në Selinë e Shenjtë në një audiencë private nga Papa Françesku. Ministri Hasani, në emër të qeverisë dhe shtetit shqiptar vlerësoi përpjekjet e Atit të Shenjtë dhe të Kishës Katolike për të ruajtur paqen, stabilitetin dhe harmoninë midis komuniteteve fetare, kombeve dhe popujve në botë. Kryediplomati shqiptar u takua gjithashtu me Sekretarin e Selisë së Shenjtë për Marrëdhëniet me Shtetet dhe Organizatat Ndërkombëtare, Kryepeshkopin Paul Richard Gallagher.



## MINISTRI HASANI NË HUNGARI: BESIMPLETË NË MBËSHTETJEN E RRUGËTIMIT EVROPIAN TË SHQIPËRISË

MEPJ Iglj Hasani zhvilloi një vizitë zyrtare në Budapest, ku u prit nga Ministri i Punëve të Jashtme dhe Tregtisë të Hungarisë, Peter Szijjarto. Ministri Hasani vlerësoi mbështetjen e vazhdueshme të Hungarisë në rrugëtimin e Shqipërisë drejt BE, teksa nënvizoi se marrëdhëniet mes dy vendeve forcohen dita-ditës. Gjatë vizitës së tij në Hungari, Ministri Hasani zhvilloi disa takime dypalëshe me zyrtarë të lartë, mori pjesë në Forumin Ballkanik të Budapestit, si dhe mbajti një kumtesë në Akademinë Diplomatike të Budapestit.



## MINISTRI HASANI NGA SPANJA: SHQIPËRIA, POTENCIAL ZHVILLIMI EKONOMIK PËR TË GJITHË MESHDEUN

MEPJ Iglj Hasani zhvilloi një vizitë zyrtare në Spanjë ku u prit në takim nga homologu i tij spanjoll, José Manuel Albares. Në fokus të bisedimeve, ishte rëndësia e diplomacisë ekonomike dhe rrugëtimi evropian i Shqipërisë. Gjatë forumit të biznesit Shqipëri-Spanjë, ministri Hasani theksoi se vendndodhja strategjike dhe mjedisi miqësor ndaj biznesit e bëjnë Shqipërinë një zgjedhje të zgjuar për investitorët dhe turistët.



## SHQIPËRIA KALON NË FAZËN E DIALOGUT TË PASMONITORIMIT NGA KOMITETI MONITORUES I ASAMBLESË PARLAMENTARE TË KIE

Shqipëria kalon në fazën e dialogut të pasmonitorimit nga Komiteti Monitorues i Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës. MEPJ Iglj Hasani e cilësoi këtë vendim si një tregues të qartë të progresit të konsiderueshëm të Shqipërisë në forcimin e shtetit të së drejtës, të drejtave të njeriut dhe demokracisë.



## MINISTRI HASANI NGA TURQIA: BE NUK MUND T'I SHMANGET ZGJIDHJEVE TË VËSHITRA

Gjatë punimeve të Forumit të Diplomacisë në Antalia, MEPJ Iglj Hasani, theksoi se Bashkimi Evropian nuk duhet të dështojë në formësimin e tranzicionit, nëse dëshiron të bëhet një aktor që mund të ndikojë realisht në ngjarjet në Lindjen e Mesme ose Ukrainë ose kudo ku do të ndodhë kriza e ardhshme.



## PREZANTOHET NISMA "PËR SHQIPTARËT NË RAJON"

Në linçimin e nismës "Për shqiptarët në rajon", MEPJ Iglj Hasani nënvizoi se Qeveria shqiptare do të vijojë punën e saj të pakushtëzuar për mbështetjen e shqiptarëve që jetojnë në Luginën e Preshevës dhe kudo në rajon.



## MEPJ DORËZON NË GJND DEKLARATËN MBI DETYRIMET LIGJORE TË SHTETEVE NË LIDHJE ME NDRYSHIMET KLIMATIKE

Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme dorëzon në Gjykatën Ndërkombëtare të Drejtësisë, deklaratën mbi detyrimet ligjore të shteteve në lidhje me ndryshimet klimatike. Në kuadrin e angazhimeve të qeverisë shqiptare në luftën globale kundër ndryshimeve klimatike, MEPJ dorëzoi një deklaratë me shkrim në Gjykatën Ndërkombëtare të Drejtësisë, në Hagë, e cila ka nisur procedurat e dhënies së një opinionimi këshillimor për shtetet anëtare të Kombeve të Bashkuara, mbi detyrimet ligjore të tyre ndaj ndryshimeve klimatike.